



AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT



BULETINI I PËRJAVSHËM

Java 6



Ishulli i Sazanit hapet për qytetarët dhe turistët

Nga 25 Korriku, Ishulli i Sazanit është hapur për turistët vendas dhe të huaj si një destinacion turistik, historik e natyror.

Hapja e Ishullit është bërë me marrëveshjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtise dhe Sipërmarrjes, nën administrimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Në ditën e parë zyrtare të hapjes së Ishullit të Sazanit si destinacion i rëndësishëm turistik grupe prej rreth 130 turistësh dhe të rinjsh nga vendi vizituan ishullin, gjithashtu mbi 140 turistë nga Shqipëria, Kosova dhe të huaj kanë zhvilluar ture në ishull, shoqëruar nga guidat turistike.



Nga 25 korriku, ishulli do të jetë i hapur përgjatë gjithë sezonit turistik për këdo që ka kuriozitet ta vizitojë atë.

Po punohet për kuadrin ligjor dhe për rregulloren që është hartuar dhe do të miratohet, ku do të caktohet edhe një biletë hyrje, pasi është shumë e rëndësishme që ishulli të vetë financohet. Pra, të gjitha të ardhurat do t'i dedikohen vetëm ishullit, ku pastaj këto të ardhura do të përdoren për restaurimin, për hapjen e qendrës së vizitorëve dhe për qendrën kërkimore shkencore që duam të themelojmë këtu dhe për menaxhimin e zonës.






Ka nisuar pastrimi në Ishullin e Sazanit

Punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit kanë filluar punën për pastrimin e Ishullit.

Ishulli do të pastrohet nga mbetjet dhe vegjetacioni përçark ku prej vitesh nuk është vënë dorë mbi to.





Ish-Ministri i Jashtëm Francez Vedrine viziton Sazanin

Ish-Ministri i Jashtëm Francez Hubert Vedrine ka vizituar Ishullin e Sazanit ku është pritur nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit. Gjatë vizitës së tij ish-Ministri është njohur me të shkuarën dhe projektet që ka qeveria shqiptare për kthimin e Sazanit në një atraksion eko-kulturor.





SHKOLLA 8-vjeçare
"22 TETORI"
SAZAN

Transformimi i Sazanit nga Bazë Ushtarake në stacion turistik, shkruan Z. Edi Rama.

Shumë vizitorë në ditë kanë filluar të prekin tashmë nga afër Ishullin e Sazanit, një perlë e jona turistike deri më sot e pashfrytëzuar, por me potencial të jashtëzakonshëm për turizmin detar, të aventurës, historisë e peshkimit.

Ndërkohë në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e famshme Franceze të Konservimit të Territorit po hidhen hapat e parë për zbatimin e projektit që do ta transformojë Sazanin në një atraksion turistik të klasit të parë duke vënë theksin tek ruajtja e vlerave natyrore dhe historike të Ishullit.






Hapja e ishullit të Sazanit ka tërhequr dhe vëmendjen e mediave të huaja.

Ato shkruajnë:

The space - 'Sazan Island: Communist Albania's most secretive military base opens to tourists'



'Symbole de la Guerre froide, l'île albanaise de Sazan s'ouvre au tourisme' shkruan FRANCE 24.



'Sazan, une île-bunker de l'Albanie communiste ouverte aux touristes' shkruan Liberation Monde.



Daily News shkruan: 'Derelict Albanian military island opens up to tourists'



HLN.be shkruan: 'Toeristen welkom in geheime legerbasis uit Koude Oorlog'

